



PK. SH.A.  
Posta e Kosovës SH.A.  
Post of Kosovo J.S.C.  
Pošta Kosova D.D.

Nr./No./Br. 01-317/22  
Data/Date/Datum 21-02-2022  
KRISTINA-KRISTINA-KRISTINA

Në bazë të nenit 20 Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 15 paragrafi 1 të Rregullores nr.01-2650/21 të datës 26.10.2021 për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më datë 16.02.2022, sipas Vendimit nr. 01-317/2022 të datës 21.02.2022, miraton këtë:

**Rregullore për Plotësim Ndryshimin e Rregullores nr.01-2650/21 të datës 26.10.2021 për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale.**

**Neni 1**

Paragrafi 1 i nenit 9 të Rregullores nr.01-2605/21 të datës 26.10.2021 për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale riformulohet si në vijim:

Komisioni Disiplinorë përbëhet prej 3-5 anëtarëve. Ky Komision duhet të jetë i balancuar sipas gjinisë. Anëtarët e Komisionit duhet të jenë zyrtarë të PK SH.A, përderisa njëri nga anëtarët duhet të jetë jurist me profesion. Komisioni duhet të ketë Kryetarin e tij.

**Neni 2**

Paragrafi 1 i nenit 13 të Rregullores nr.01-2605/21 të datës 26.10.2021 për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale riformulohet si në vijim:

Komisioni i Ankesave dhe Parashtresave përbëhet prej 3-5 anëtarëve. Ky Komision duhet të jetë i balancuar sipas gjinisë. Anëtarët e Komisionit duhet të jenë zyrtarë të PK SH.A, përderisa njëri nga anëtarët duhet të jetë jurist me profesion. Komisioni duhet të ketë Kryetarin e tij.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi, pas miratimit paraprak të Bordit të Drejtorëve të NPQ "Posta Kosovës" SH.A.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve  
Fadil Bejta